

IMMEDIATE RISK ASSESSMENT NEEDS IN KOSOVO

Sherif Sejdiu

“Kolegji Biznesi”, Prishtina, Kosovo, sherifi_sejdiu@hotmail.com

Lirije Krasniqi

“Kolegji Biznesi”, Prishtina, Kosovo, lilakrasniqi2016@hotmail.com

Abstract: Given that our country is a country with a population of about 2 million and the state is still not consolidated in many areas risk assessment is a novelty and very necessary for the lives of Kosovo's employees.

It is a fortunate and well-intentioned idea that has existed in different parts of the world and has recently begun to receive the attention it deserved, even after the loss of many workers' lives in the workplace.

It is unfortunate how many lives people have lost precisely because of the lack of risk assessment and occupational health. Hundreds of families have been identified w

ho, precisely because of the lack of risk assessment at work, are now missing their loved ones and have tragically lost their lives in the workplace.

The Occupational Safety and Health Act states that the main burden, both organizational and financial, of creating safe and healthy working conditions rests with employers. Under the Act, the employer also designates responsible persons within staff who are responsible for occupational health and safety. Unlike regional states where there is a legal requirement for companies to establish occupational safety and health councils, this is not required in Kosovo.

Workplace risk assessment is a legal obligation that must be met by all employers. With the legislation in force, it is the licensed legal entities that have the power to prepare the risk assessment document by ascertaining the risk at the workplace and to give appropriate recommendations for reducing the risk level, possibly at negligible risk, because the country zero risk work does not exist.

Occupational Safety and Health (OSH) is an important component of employee social protection against negative aspects of work, accidents at work and occupational diseases, improves job satisfaction and enhances labor market functioning and quality of human capital.

On the other hand, poor standards of occupational safety and health, occupational injuries, death accidents and occupational illnesses place a heavy burden on the national economy due to payments from social security scheme, hospital expenses, retraining and replacement of employees. and loss of productivity.

In general, OSH is defined as the science of anticipating, recognizing, assessing and controlling risks arising at or from the workplace that may impair the health and well-being of employees, given the potential impact on neighboring communities and the general environment.

Keywords: State, risk assessment, workplace, organizational and legal obligation.

VLERËSIMI I RISKUT NEVOJË IMEDIATE NË KOSOVË

Sherif Sejdiu

“Kolegji Biznesi” sherifi_sejdiu@hotmail.com

Lirije Krasniqi

Kolegji Biznesi”, lilakrasniqi2016@hotmail.com

Abstrakt: Duke pasë parasysh se vendi jonë është një vend me një popullsi afër 2 milion banorë dhe shteti është ende i pa konsoliduar në shumë fusha vlerësimi i rrishtit është një risi dhe shumë e nevojshme për jetën e të punësuarve në Kosovë.

Është fat dhe shumë e qëlluar kjo ide e cila në vendet e ndryshme të botës ekziston ka herë ndërsa tek ne kohët e fundit ka nisur të merr vëmendjen e duhur, fatqësisht pas humbjes së jetës së shumë puntorëve në vendin e punës .

Është për të ardhur keq sa jetë njerzish kanë humbur pikërisht për mungesën e vlerësimit të rrishtit dhe shëndetit në punë. Janë evidentuar me qindra familje të cilat pikërisht nga mungesa e vlerësimit të rrishtit në punë tani u mungojnë të dashurit e tyre dhe kanë humbur jetën tragjikisht në vendin e punës .

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë thotë se barra kryesore, si ajo organizative ashtu dhe ajo financiare, për të krijuar kushte të punës të sigurta dhe të shëndetshme i bie punëdhënësit. Sipas Ligjit, punëdhënësi gjithashtu cakton persona përgjegjës brenda personelit të cilët janë përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë. Ndryshe me shtetet rajonale ku është kërkesë ligjore që në kompani të formohen këshille të sigurisë dhe shëndetit në punë, një gjë e tillë nuk kërkohet në Kosovë.

Vlerësimi i riskut në vendin e punës është detyrim juridik, të cilin duhet ta kryejnë të gjithë punëdhënësit. Me legjislacionin në fuqi, janë personat juridik të licencuar që kanë kompetencë të përgatisin dokumentin për vlerësimin e riskut duke konstatuar riskun në vend të punës si dhe për të dhënë rekomandimet e duhura për zbritjen e nivelit të riskut, mundësisht në risk të papërfillshëm, sepse vendi i punës me zero risk nuk ekziston

Siguria dhe Shëndeti në Punë (SShp), është komponent i rëndësishëm i mbrojtjes sociale të punonjësve kundër aspekteve negative të punës, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, përmirëson kënaqësinë në punë dhe fuqizon funksionimin e tregut të punës dhe cilësinë e kapitalit njerëzor.

Fjalët kyçe: Shteti, vlerësimi i riskut, vendi i punës, organizative dhe detyrimi juridik.

1. HYRJE

Standardet e dobëta të sigurisë dhe shëndetit në punë, lëndimet në punë, aksidentet me vdekje dhe sëmundjet profesionale shkaktojnë një barrë të rëndë për ekonominë kombëtare për shkak të pagesave nga skema e sigurimeve shoqërore, shpenzimeve spitalore, rikualifikimit dhe zëvendësimit të punëmarrësve dhe humbjes së produktivitetit.

Në përgjithësi SShp përkufizohet si shkenca e parashikimit, njohjes, vlerësimit dhe kontrollit të risqeve që burojnë në ose nga vendi i punës i cili mund të dëmtojë shëndetin dhe mirëqenien e punëmarrësve, duke patur parasysh edhe impaktin e mundshëm në komunitetet fqinjë dhe në mjedisin e përgjithshëm (QRKS, 2019).

Siguria në punë dhe shëndeti i punëtorëve të ekspozuar profesional nuk paraqet vetëm një qasje formale me të cilën komuniteti dëshiron ta deklarojë përcaktimin e vet lidhur me avancimin e mjedisit të punës dhe mirëqenien e punëtorëve. Përkundrazi, kjo është një kategori me orientim të lartë ekonomik, me të cilën duhet të mbrohen interesat e punëtorëve, ndërmarrjeve, kompanive etj. E drejta për shëndet dhe e drejta për siguri në punë janë të drejta universale të njeriut dhe të punës. Prandaj, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) nga themelimi i saj e deri më sot ka miratuar dhe publikuar 187 deklaratat dhe 198 rekomandime nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë (Doracak për vlerësimin e rrezikut profesional, 2019).

Objektivi themelor për vlerësimin e rrezikut është se Punëdhënësi të ndërmarrë një sërë masash në lidhje me vendin e sigurt dhe të shëndetshëm për përmbushjen e detyrave të punës:

- Parandalim të rrezikut profesional,
- Informim të personelit - të punësuarve në ndërmarrje,
- Trajnimi,
- Zbatim të organizuar të masave.

Vlerësimi i rrezikut përsëritet gjatë çdo ndryshimi të kushteve, mjedisit, teknologjisë dhe materialeve (IP, 2019). Vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet zbatimit të masave të reja dhe eliminimit të rreziqeve dhe rrezikshmërive me ç'rast duhet pasur kujdes që gjatë eliminimit të një rreziku të mos krijohet rrezik tjetër. Siguria dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës (ISHP, 2019).

2. RREZIKU, RREZIKSHMËRITË DHE NDARJA

Me nocionin rrezik nënkuptohet masa e shprehur kuantitative e mundësisë - probabilitetit që si rezultat i ekspozimit të shfaqen efekte të dëmshme mbi shëndetin dhe jetën e punëtorëve të ekspozuar profesional.

Burime të rrezikshmërisë dhe rrezikut janë materia, sendet, vendi dhe mjedisi i punëtorëve në vendin e punës. Gjatë analizave permanente dhe ndjekjes permanente të kushteve në vendet e punës që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt mbi shëndetin e personelit të përgjithshëm të ndërmarrjeve, vlerësimi i rrezikut ndikon mbi reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve.

Rreziku paraqet përmbledhje të dy komponentëve:

1. Probabiliteti për shfaqjen e faktorëve të dëmshëm në mjedisin e punës dhe
2. Probabiliteti për shfaqjen e efekteve negative konsekuente mbi shëndetin e punëtorëve të ekspozuar.

3. RREZIKSHMËRITË DHE NDARJA

Rrezikshmëritë ndahen sipas llojit dhe natyrës së rrezikut edhe atë:

Mekanike: Pajisja dhe mjetet e punës nuk janë standardizuar konform rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Përdorimi joadekuat, mirëmbajtja dhe kontrolli i servिसimi periodik . Sende në lëvizje dhe zhvendosja – të mprehta, me majë dhe të papërpunuara. Lëndime fizike gjatë zhvendosjes – ngritjes, shtyrjes, hedhjes dhe tërheqjes, vegla manuale, sende të nxehta ose të ftohta. Përfshirja e pjesëve të pajisjes personale për mbrojtje, gabime në vendosjen e konstruksionit.

Rreziku nga energjia elektrike: Kontakti me aparatet përçuese elektrike të pambrojtura dhe me veglat nën tension, rrufeja dhe shkarkimi elektrik.

Rreziku nga transporti dhe lëvizja: Lëvizja: dysHEME ose terase e lëmuar, e rrëshqitshme, e parrafshët dhe e papastër, Rrëzimi: skela, lartësi pa mbrojtje, shkallë, kthesa, ortek materialesh.

Zjarri dhe shpërthimet: Instalim i pambrojtur që lehtë mund të digjet dhe materiale djegëse, materie djegëse të lëngshme, karburante dhe materiale djegëse, Fizike dhe Kimike.

4. PËRMBAJTJA E VLERËSIMIT TË RISKUT

Vlerësimi i rrezikut është bazë për vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm, ndërkaq vetë procesi i vlerësimit të rrezikut është përgjegjësi ndaj punëtorëve për nxitjen e sigurisë, motivimit dhe besimit të tyre ndaj ndërmarrjes.

Vlerësimi i rrezikut është indikator i orientimit të qëndrueshëm afatgjatë të ndërmarrjes, përmirësimit të kapaciteteve, produktivitetit dhe profitit.

Sistemet bashkëkohore, funksionale dhe të harmonizuara lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë, ashtu siç janë inkomporuar në shumë vende të zhvilluara dhe në të gjitha vendet anëtare të BE-së, kryesisht janë të orientuara kah nevoja për ruajtjen dhe rritjen e interesave ekonomike të punëdhënësve (PKIE, 2019). Pikërisht për këtë imponohet domosdoshmëria e implementimit sa më të shpejt të legjislacionit evropian, normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian (BE), të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) dhe të Organizatës Shëndetësore Botërore (OSHB) në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit të punëtorëve.

5. EVALUIMI DHE PRIORITETI I RREZIKUT

Që të vendoset lidhur me atë se a është rreziku i VOGËL; I MESËM; ose I MADH, duhet ta kemi parasysh:

Nivelin e probabilitetit se dëmi do të shfaqet dhe do të shkaktojë efekte të dëmshme negative,

Në ç' masë është serioziteti/rëndësia e dëmtimit,

Sa shpesh dhe sa punëtorë i ekspozohen dëmit.

Vlerësimi që mbështetet mbi gjykimin pa përmbushjen e shkathtësive dhe teknikave të veçanta mund të jetë i mjaftueshëm për:

Punë me dëme të cilat shkaktojnë shqetësime të vogla,

Vende pune në të cilat rreziku është i identifikuar dhe në të cilat ekziston mundësi për kontroll.

Në rast të dëmeve ose aktiviteteve më komplekse, mund të kërkohet njohuri, mbështetje dhe këshilla profesionale.

6. OBJEKTIVI THEMELOR PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

Punëdhënësi të ndërmarrë një sërë masash në lidhje me vendin e sigurt dhe të shëndetshëm për përmbushjen e detyrave të punës:

Parandalim të rrezikut profesional,

Informim të personelit - të punësuarve në ndërmarrje,

Trajnimet.

7. ZBATIM TË ORGANIZUAR TË MASAVE

Vlerësimi i rrezikut përsëritet gjatë çdo ndryshimi të kushteve, mjedisit, teknologjisë dhe materialeve (FZRSH, 2018). Vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet zbatimit të masave të reja dhe eliminimit të rreziqeve dhe rrezikshmërive me ç'rast duhet pasur kujdes që gjatë eliminimit të një rrezik të mos krijohet rrezik tjetër.

Si expert i certifikuar nga MMS ne personalisht jemi interesuar dhe kemi hulumtuar, analizuar dhe vlerësuar disa vendëpunishte, biznese të lloj llojshme, pompa benzine, ndërtues objektësh, objekte hoteliere, shërbyes sigurimi të objekteve e tje tje në vendin tonë me qëllim të hulumtimit dhe vlerësimit të rrezikut në punë dhe sigurinë e punëtorëve që punojnë në këso lloj biznese.

Vetëm në rajonin e qytetit të Prishtinës me rrethinë aktualisht janë mëse 50 vendëpunime (IPK, 2019), ndërtime të larta të objekteve banesore dhe objekteve individuale banesore. Gjatë kësaj analize kërkimore kemi ardhur deri te konkludimi i një rreziku permanent për të punësuarin dhe statistikisht na japin shifra alarmante deri në 87% të punëdhënësve nuk i kushtojnë rëndësi masave mbrojtëse për punëtorin nga i cili përfitojnë vlera të majme të mjeteve dhe në fund pagën e punëtorit e japin me pagesa të llojllojshme her mes bankave e në shumë raste pagesa kesh gjë që na bën të ndjehemi të rrezikuar edhe si shtet sepse mirfilli dihet që shteti mbahet nga tatimet.

Respektivisht as inspektoriati i punës dhe mbrojtjes së punëtorëve nuk është në nivelin e kënaqshëm. Autoritetet dhe ministria e cila duhet të merret me këtë punë nuk është e gatshme dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme për tu përballur me këtë problematikë, sa e rrezikshme aq më shumë e dhimbshme për faktin se këtu kemi të bëjmë me jetën e punëtorëve të cilët për hir të një kafshate buke duke u munduar të mbajnë familje nuk janë në gjendje as ti kërkojnë mjetet elementare për të siguruar jeteën e vetë nga këto rreziqe (QPA, 2019).

Në Kodin Penal të Kosovës janë definuar edhe dënimet për të gjitha shkeljet të cilat rezultojnë me lëndime apo vdekje në vendin e punës (GZRK, 2018). Sipas nenit 367 të këtij Kodi, kushdo që dëmton ose heq pajisjet mbrojtëse duke rrezikuar jetën e punëtorëve dënohet me burgim prej **1 deri në 8 vjet**, ndërsa nëse pajisjet mbrojtëse nuk janë vendosur fare ose nuk janë mirëmbajtur, personat përgjegjës dënohen prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Në rastet e lëndimeve më të rënda, personi përgjegjës mund të dënohet me një deri në 10 vite burgim, ndërsa nëse rasti pason në vdekjen e një apo më shumë personave përgjegjësi mund të dënohet prej një deri në **12 vjet burgim** (GZRK, 2019).

Është për keqardhje se si kompetentët nuk marrin mundin as të interesohen për sigurinë e jetës së të punësuarve, është e dhimbshme dhe e turpshme kur inspektoriat si organ i shtetit në një rast (raste të tilla nuk janë të pakta) kur në një rast që është i evidentuar edhe zyrtarisht pronari i ndërmarrjes dënohet me gjobë 2.000 Euro dhe a e dini për çfarë rasti?

Humbje e jetës së një të punësuarit i cili ka humbur jetën në vendin e punës për shkaqe sigurie.

Nga kjo që u tha më lartë unë jemi të vetëdijshëm se nuk mund ta ndryshojmë këtë të vërtetë të dhimbshme e cila po na përciell kohë të gjatë, mirëpo të paktën shpresojmë se është një trokitje sa do e vogël në ndërgjegjen e kompetentëve vendim marrës të cilët puëtorët i shofin vetëm në ekrane televizive, aq më keq edhe në ekranet televizive puëtorët nuk dalin për tu falenderuar për punën që bëjnë por radha e tyre për të dalë në media vjen fatkeqësisht kur humbin jetën .Mendoj se vetëdijësimi, disiplinimi i punëdhënsit në radhë të parë pastaj edhe puntorin me rreziket që janë gjithmonë prezente në vendine punës, dhe me angazhimin e ekspertëve të kësajë lamije do të ishte në interes të vendit dhe do të kemi më pak raste të tilla .

Sipas të dhënave nga Inspektoriat i Punës në vendin tonë gjatë vitit 2018 janë të lajmëruara 147 raste të aksidenteve në vend të punës dhe si pasojë e këtyre aksidenteve 22 persona kanë humbur jetën, shifër kjo alarmante për sigurinë e jetës në vendin e punës gjë që na bën të jemi të vëmendshëm se kah po shkon vendi ynë sa i përket sigurisë në punë.

Aktualisht ligji për mbrojtjen e të punësuarve ekziston por lind pyetja sa gjen zbatim ?

Të gjithë e dimë dhe jemi të informuar se mandati i IPK-së është që të mbikëqyrë nëse vlerësimi i riskut në vendin e punës është bërë sipas legjislacionit (UNMIK, 2017).

Me numrin e inspektorëve i cili është mjaftë i ulët është e pa mundur të kemi sukses në ruajtjen e jetës së punëtorit Inspektorati i Punës ka mandat që të mbikëqyrë nëse vlerësimi i riskut në punë është bërë sipas legjislacionit gjatë inspektimeve që kryen. Natyrisht ky proces është proces i ri dhe vazhdimisht duhet të avancohet. Inspektorati i Punës është në dispozicion dhe ofron bashkëpunim shumë korrekt për të gjithë akterët e interesuar që të kontribuojnë në ngritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë mirëpo është për keqardhje numri i angazhuar i inspektorëve në inspektoriat dhe është nevojë imdiate të shtohet numri i inspektorëve dhe të shpëtohet jeta e punëtorëve nga kjo rrezikshmëri e pa kontrlluar e cila po merr jetë thujase çdo ditë.

8. PËRFUNDIMI

Nga kjo që u tha më lartë konstatojmë se jeta e puntorit është në rrezik permanent, jo nga lufta por nga neglizhenca e kompetentëve të cilët marrin të ardhura nga taksat e qytetarëve dhe nuk kryejn punën e tyre me nderë. Si pasojë e neglizhencës dhe mos respektimit të ligjeve në fuqi qdo ditë është duke u shtuar lista e vdekjeve në vendin e punës (**22 vetëm në vitin 2018**) të regjistruar **por sa janë të pa rexhistruar sa jan fshehur nga organet** kjo nuk dihet . Dhe ku kan humbur jetën ? Aty ku njeriu duhet të shkoj me vullnet dhe me shpresën se do siguroj të ardhura për famoljen. Çdo ditë shtohet lista e invalidëve të punës, shtohet lista e të lënduarëve dhe si pasojë e kësaj rëndohet bugjeti i shtetit nga po ata njerëz që marrin mjete nga shteti dhe me mos punën e tyre dëmtojnë jetë njerzish .

LITERATURA

OPM. (2019, 10 11). *Doracak për vlerësimin e rrezikut profesional* Gjetur në Organizata e punës në Maqedoni: <http://www.orm.org.mk/images/documents/priracnici/priracnik%20za%20bz%20al.pdf>

FZRSH. (2018, 02 11). *Udhëzim i MZHETS nr. 177, datë 26.12.2013*. Gjetur në Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë: http://ishmt.gov.al/wp-content/uploads/2018/04/10.-Udh%C3%ABzim-177_2013-P%C3%ABr-metodat-e-klasifikimit-t%C3%AB-risqeve-dhe-t%C3%AB-vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-riskut-serioz.pdf

GZRK. (2018, 01 11). *LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË*. Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>

GZRK. (2019, 09 18). *KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS*. Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

- IP. (2019, 11 02). *Manual për vlerësimin e rrezikut në punë*. Gjetur në Inspektorati Shtetrorë i Punës dhe shërbimeve të Punës : <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Manual-per-vleresimin-e-riskut-me-steme-300718.pdf>
- IPK. (2019, 11 21). *Raporti i Punës për vitin 2017 nga Inspektoriati i punës*. Gjetur në Inspektorati i Punës së Kosovës: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Raporti-i-Punes-per-vitin-2017-nga-Inspektoriati-i-punes-2.pdf>
- ISHP. (2019, 10 4). *PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME RREZATIMET JOJONIZUESE NË VENDIN E PUNËS”*. Gjetur në Instituti i Shëndetit Publik: <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/Nr.-843-dat%C3%AB-3.12.2014Rreg-per-mbrojtjen-e-punemarresve-nga-risqet-lidhur-me-rrezatimet-jojonizuese-ne-vendin-e-punes.pdf>
- PKIE. (2019, 8 11). *VENDIM Nr. 246, datë 9.5.2018* . Gjetur në Këshilli i Ministrave: <http://punetejashme.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/vkm-nr-246-date-9-5-2018-2-plani-kombetar-per-integrimin-evropian-2018-2020.pdf>
- QPA. (2019, 11 02). *TË DREJTAT E PUNËTORËVE (KORNIZA LIGJORE), SIGURIA NË PUNË DHE MEKANIZMAT ZBATUES*. Gjetur në Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur: http://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2015/02/QPA_Ligji-i-punes_shqip.pdf
- QRKS. (2019, 9 30). *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021*. Gjetur në Qeveria e Rrepublicës së Kosovës: https://www.min-rks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_se_republikes_se_kosoves_2017_2021.pdf
- UNMIK. (2017, 04 22). *RREGULLORE NR. 2003/4 PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS MBI INSPEKTORATIN E PUNËS SË KOSOVËS* . Gjetur në Rregullorja e Inspektoratit të Punës : <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Ligji-mbi-Inspektoratin-e-Punes.pdf>